



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional “Administrim
Zyre”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Edlira Martiri
2. PhD. Klodian Muço

Shtator/2021

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e Studimit me Karakter Profesional në “Administrim Zyre” të ofruar
nga Kolegji Profesional i Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Profesional i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Administrim Zyre
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 356, datë 28.06.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Studim me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademik (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE/ 6 PAK v.a 2019-2020 6 PAE/ 6 PAK v.a 2020-2021
18	Numri i studentëve:	13 Studentë v.a 2019-2020 3 Studentë v.a 2020-2021
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Profesional i Tiranës është licensuar me VKM nr. 699, datë 26/08/2015, "Për licensimin e Institucionit të Arsimit të Lartë privat me statusin e kolegjit profesional i Tiranës".

Ai përbëhet nga dy departamente që ofrojnë 12 programe studimi të larta profesionale, jo universitare, me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë me kohë të plotë, që zgjasin 2 vjet me 120 kredite.

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017", Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit "Administrim Zyre".

Programi në fjalë është program profesional 2 vjeçar, me kohë të plotë me 120 kredite i cili ofrohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në KPT.

Programi është në gjuhën Shqipe. Programi në fjalë është licensuar me Urdhrin nr. 356, datë 28.06.2018 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Programi në fjalë synon të pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme teorike dhe praktike për të punuar si asistent administrativ zyre si në sektorin publik si në sektorin privat.

Programi kërkon të përgatiti administratorë zyre apo asistent drejtues zyre, si person kyç që mbështet që mbështet drejtuesin e zyrës në aspektin organizativ dhe menaxherial. Një figurë kjo prezente në çdo industri, por pa një arsimim specifik.

Programet e lëndëve për këtë program janë kryesisht të karakterit teknik dhe pjesërisht përbëhen nga lëndë që kanë bazë IT dhe programimin, apo lëndë që s'kanë lidhje direkte me funksionet që duhet të zhvillojë asistenti administrativ. Por, theksojmë se ato lëndë që janë të profilit, kanë një shpërndarje të mirë të raportit teorik e praktik, gjë që është element bazë i programeve profesionale.

Kurrikula mësimore është në ndonjë rast në funksion të kompetencave të stafit akademik dhe jo në funksion të studentit. E themi këtë pasi: programi studimor ka si qëllim të ofrojë profesionistë për tregun e punës për Organizatat jo fitimprurëse, për sektorin privat ku roli i administratorit është jetik për mbarvajtjen e biznesit, për sektorin publik në nivel qendror ose lokal, por megjithatë nga syllabuset e lëndëve vërehen se ato përmbajnë informacione mbi programimin mbi IT, gjuhën shqipe e shumë pak informacione mbi menaxhimin apo komunikimin dhe organizimin e biznesit. Niveli i dijeve të ofruara në këtë program studimor nuk janë të konfirmuara nëse përkojnë me kompetencat e tregut të punës, pasi mungon një studim i mirëfilltë në lidhje me ofertën akademike të këtij programi studimi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i vlerësimit të jashtëm, të asistuar edhe nga specialisti i ASCAL, Msc. Muhamed Prezja, për realizimin e procesit të vlerësimit, konsultuan me rigorozitet të gjithë dokumentacionin e ngarkuar në portalin e ASCAL nga Kolegji Profesional i Tiranës, për të vazhduar me vizitat në institucion.

Përgjatë vizitave u realizuan takime me drejtues të institucionit, me drejtues të departamenteve, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin pedagogjik, studentë, sekretarinë mësimore, administratën, arkivin etj. Gjithashtu u bë një vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij institucioni, në bibliotekën e IAL, në sallën informatike, në laboratorët etj.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim.

Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, procedurave të regjistrimit të studentëve në sekretari, me dosjet e stafit akademik dhe me procesverbalet e provimeve. Gjithashtu, gjykimi i grupit të punës u mbështet në intervistat e marra nga grupet e ndryshme të interesit. I gjithë procesi u asistua nga Kordinatori Teknik i ASCAL z. Muhamed Prezja. GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit rreth draft-raportit derguar, sqaron si më poshtë:

1. KOMENTI I KPT: Në lidhje me komentin e vendosur në faqe 3 Programet e lëndëve për këtë program janë kryesisht të karakterit teknik dhe pjesërisht përbëhen nga lëndë që kanë bazë IT dhe programimin, apo lëndë që s'kanë lidhje fare me funksionet që duhet të zhvillojë asistenti administrativ. Kurrikula mësimore është në funksion të kompetencave të stafit akademik dhe jo në funksion të studentit. E themi këtë pasi: programi studimor ka si qëllim të ofrojë profesionistë për tregun e punës për Organizatat jo fitimprurëse, për sektorin privat ku roli i administratorit është jetik për mbarvajtjen e biznesit, për sektorin publik në nivel qendror ose lokal, por megjithatë nga syllabuset e lëndëve vërehen se ato përmbajnë informacione mbi programimin mbi IT, gjuhën shqipe e shumë pak informacione mbi menaxhimin apo komunikimin dhe organizimin e biznesit. Niveli i dijeve të ofruara në këtë program studimor nuk përkojnë më kompetencat e tregut të punës.

Në lidhje me këtë pikë, dëshirojmë të sqarojmë se: Në një shoqëri ku ritmet e zhvillimeve teknologjike janë të larta, dijet dhe aftësitë profesionale janë të rëndësishme në një treg pune dhe ambiente pune gjithnjë e më shumë të lidhura me teknologjinë dhe mundësitë e shumta që ajo ofron.

Zhvillimet teknologjike dhe dinamika e tyre kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe në aktivitetet e zyrës, qoftë kjo në sektorin publik dhe atë privat, duke e kthyer atë në një nga organizatë të domosdoshme, me kërkesa në rritje përsa i përket aftësive dhe dijeve për profesionistë me aftësi praktike. Sa më e madhe dhe komplekse të jetë ndërmarrja si në sektorin privat dhe atë publik, aq më e rëndësishme është puna e zyrës në aspektin e çështjeve organizative.

Programi i studimit me karakter profesional "Administrim zyre" synon të pajisë studentin me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme teorike dhe praktike për një mjedis zyre modern dhe në përputhje me zhvillimet e tregut të punës. Programi i studimit dhe përmbajtja e tij është konceptuar e mbështetur në 3 aftësime kryesore të cilat janë:

- a. Aftësim kompjuterik dhe informatik.

- b. Aftësim ekonomik – ligjor aplikativ.
- c. Aftësimi administrativ

Bazuar për sa më sipër, plani mësimor është hartuar për të bërë një ndarje të barabartë në lëndë në përvetësimin e të tre aftësimeve që parashikon ky program studimi.

GVJ: Komentet e shqyrtuara më lart nga IAL janë pjesë e përshkrimit të përgjithshëm të RVJ, ku pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur gjetjet kryesore. GVJ konfirmon edhe njëherë qëndrimin e tij për këtë pikë dhe nuk merr në konsideratë komentin e IAL-së.

2. KOMENTI I KPT: Faqe 3. Paragrafi 6 *Kurrikula mësimore është në funksion të kompetencave të stafit akademik dhe jo në funksion të studentit.*

Standardi 1.1(Kriteri 3): *Ky program administrohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, për pasojë, qëndron tërësisht në përputhje me përmbajtjen e programit mësimor të tij.*

Si dhe Standardi 5.4 (kriteri 4): Nga konsultimi me aneksin 19, sikurse bisedat me pedagogët që lëvrojnë lëndët, krijohet bindja e arsyeshme se hartimi, implementimi dhe përmirësimi i programeve të studimit është më tepër funksion i lëndëve që zhvillohen në programet e tjera të KPT sesa produkt i bashkëpunimit me studentët, nevojat individuale të KPT dhe krijimit të një niche-je në tregun e arsimit të lartë e më tej të punësimit. Kjo është një praktikë e vetëkuptueshme nisur nga numri i studentëve që studiojnë në këtë program dhe pjesën e tregut që zë institucioni në përthithjen e studentëve.

Duke veçuar këtë koment, ashtu si del në pah dhe nga Evidenca 1 “Plani mësimor i programit”, duhet të theksojmë se 70% e lëndëve janë specifike vetëm për këtë program studimi ku më konkretisht nga 18 lëndë që zhvillohen në total, 12 prej tyre janë lëndë që iu ofrohen vetëm studentëve të këtij programi studimi. Gjithashtu duhet të theksojmë se 6 lëndët që zhvillohen edhe në programe të tjera të studimit janë pjesë e domosdoshme e formimit dhe përgatitjes të studentëve për tregun e punës. Kjo sepse, krahas formave klasike të punës së zyrës, marrin rëndësi dhe aftësimet në programe kompiuterike, në aplikacione, në të dhëna, faqe internet etj., për të shkuar drejt atyre që njihen si sipërmarrjet digjitale.

Zyra e së sotmes është vendqëndrimi dhe pikëtakimi i shumë paisjeve smart, i programeve dhe aplikacioneve që lehtësojnë proceset që nga ana tjetër kërkojnë dhe profesionistë me dije praktike për t’i përdorur ato dhe shfrytëzuar në maksimum.

Niveli i dijeve të ofruara në këtë program studimor nuk përkojnë me kompetencat e tregut të punës.

Ky koment bie në kundërshtim me vlerësimin e dhënë në standartin II.2, kriteri 5 ku shprehimisht thuhet se: *Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese të paraqitura në Rregulloren e Programit të Studimit dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.*

Për më tepër duhet të theksojmë se ky program studimi është propozuar dhe miratuar pas një punë kërkimore të tregut të punës të bërë nga Departamenti përgjegjës sic evidentohet edhe në Evidencën 2 “Studimi i tregut”.



GVJ: Në dokumentin e ridërguar "Evidenca 2: Studimi i tregut", janë të përshkruara vlerësimet e bëra nga IAL për hapjen e programit të studimit "Administrim zyre", ku evidentohet se e vetmja metodologji e ndjekur në këtë analizë, për të justifikuar këtë hapje është kërkimi i bërë pranë QKB për numrin e bizneseve aktive të regjistruara. Ky mund të jetë një indikator për të filluar analizën dhe studimin, por assesi nuk mund të konsiderohet si studim tregu. Nuk janë paraqitur tregues të tjerë, nuk janë specifikuar grupet target për studentët e rinj të mundshëm, nuk është analizuar konkurrenca, nuk është paraqitur një plan financiar sado minimal në këtë "analizë tregu", që do të justifikonte interesin për hapjen e programit të studimit. Për mbarëvajtjen sa më të mirë të këtij programi, për një depërtim edhe më të mirë në treg, për një numër më të lartë regjistrimesh, GVJ sugjeron ribërjen dhe ndjekjen e një metodologjie për studimin e tregut, në kuadër edhe të përmirësimit të ofertës akademike, por edhe të strukturës mësimore (që lidhet me komentet e mëparshme), pra të lëndëve, bazuar edhe në programe të ngjashme ndërkombëtare profesionale, si dhe në atë çfarë lokalisht kërkohet në vendin tonë për profesionistë të këtij drejtimi. Ky studim mund t'ju japë të drejtë ju në vendimet tuaja, por gjithsesi është i domosdoshëm të kryhet e për pasojë në këtë fazë të akreditimit. Pra, GVJ konfirmon edhe njëherë qëndrimin e tij për këtë pikë dhe nuk merr në konsideratë komentin e IAL-së.

3. KOMENTI I KPT: Standardi 1.1 (kriteri 4) Argumentet qëndrojnë, bazohen në të dhëna të përgjithshme dhe gjykime të asaj se çfarë kërkohet në realitetin e sotëm të menaxhimit të organizatave, por nuk ofrohet ideja e realizimit të një studimi të mirëfilltë mbi tregun lokal e kombëtar.

Standardi 1.1 (kriteri 6) Ky kriter nuk plotësohet. Dokumentet e referuara në RVB i vlejné programeve të "Teknologjisë së Ajrimit dhe Kondicionimit", si dhe "Elektronikë".

Në lidhje me dokumentet e referuara në RVB për këtë standard, komentimi i kriterit është plotësuar bazuar në programe të tjera studimi si shembull ilustrimi për arsye se KPT ende nuk disponon një raport mbi studentë të diplomuar, për sa kohë që ky është viti i parë që do të ketë të diplomuar në këtë program studimi.

GVJ: Citojmë nga RVJ: "**Kriteri 6.** Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës." Për këtë kriter, në RVB referenca e vendosur me nr. 26 i përkon Evidencës 58 "Punësimi/komunikimi me dhe për bizneset". Ky dokument përmban foto të një aktiviteti të zhvilluar me studentët e degëve të përmendura, pra sic cilësohet në RVJ nuk përkon me programin e studimit "Administrim Zyre". GVJ konfirmon edhe njëherë qëndrimin e tij për këtë pikë dhe nuk merr në konsideratë komentin e IAL-së.

4. KOMENTI I KPT: Standarti 1.3 (kriteret 2.3.4) (i gjithi kreditet dhe lendet, syllabuset e munguara)

Përsa i përket syllabuseve të munguara, duke kërkuar ndjesë, mendojmë se ndonjë ngatërresë jo e qëllimtë, gabim njerëzor mund të ketë ndodhur gjatë procesit të skanimit të dosjes,

ndërkohë materialet janë të plota dhe të dorëzuara në dosjen fizike. Për çdo rast lutemi gjeni bashkëlidhur Evidencën 3 “Syllabuset e programit të Studimit”.

Standardi 2.2 (kriteri 5) Gjithashtu, natyra praktike e profilit duhet të saktësohet më qartë dhe në syllabus-et e lëndëve, në të cilat duhet të saktësohen orët në laborator dhe punët praktike në terma të krediteve.

Në lidhje me këtë sqarojmë se Syllabuset janë të hartuar sipas udhëzimeve të dërguara nga Ministria e Arsimit dhe kreditet janë shpërndarë sipas peshës së ngarkesës dhe natyrës së lëndës.

GVJ: Pas shqyrtimit të syllabuseve të vendosura në dosjen e IAL (Evidenca 3: “Syllabuset e programit të studimit”) konstatohet riorganizimi i syllabuseve dhe vendosja e atyre të munguara. Komenti merret në konsideratë.

5. KOMENTI I KPT: Standardi 3.2 (kriteri 4) Në RVB, përmendet që studentët mund të aksesojnë biblioteka online, por nuk përmendet se cilat janë ato ku studentët kanë të drejtë akses.

Biblioteka online që kemi përfshirë në raport nuk është specifikuar për shkak se është e tipit “Open Source”. Gjithashtu, ashtu si është theksuar, KPT ka një marrëveshje bashkëpunimi me UET, që mundëson *inter alia* dhe përdorimin e infrastrukturës së bibliotekës së UET nga ana e KPT.

GVJ: Studentëve duhet tu jepet mundësia e ambjenteve të bibliotekave fizike, si dhe të orientohen drejt përdorimit të bibliotekave online, duke u qartësuar ato që përkojnë me formimin e tyre, apo ato që IAL ka marrë në shqyrtim e ka miratuar. Bibliotekat “Open Access” (ndoshta lapsus për Open Source) kanë nevojë gjithashtu të cilësohen. IAL mund t’i saktëson bibliotekat online që shfrytëzon (qoftë ato open access, apo dhe ato që disponon në bazë të marrëveshjes me UET) edhe në këtë shkresë sqaruese. Pra, GVJ nuk arrin të evidentojë bibliotekat online ku studentët kanë akses, e për pasojë nuk e merr në konsideratë komentin e IAL-së”

6. KOMENTI I KPT: Standardi 3.4 (kriteri 5) Nga shqyrtimi i procesverbaleve të provimeve në sekretarinë mësimore të subjektit, konstatohet se këto procesverbale firmosen nga titullari i lëndës, përveç firmave procedurale që ishin ajo e dekanit (jo përgjegjësit të departamentit) dhe e sekretares.

Në lidhje me këtë pikë, sjellim në vëmendje dhe saktësojmë se në bazë të legjislacionit në fuqi, KPT si kolegji profesional i lartë është i organizuar në departamente; për këto institucione nuk parashikohet dekani si autoritet drejtues. Bazuar në rregulloren e KPT, procesverbalet e provimeve firmosen nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e përgjithshme e KPT.

GVJ: Për saktësimin e këtij komenti, GVJ nuk arrin të gjejë bazë ligjore për firmosjen e procesverbaleve nga ana e Dekanit, e për pasojë nuk e merr në konsideratë komentin e IAL-së”.

7. KOMENTI I KPT: Standardi 3.5 (kriteri 1) Në mjaft raste, syllabuset kishin një literaturë shumë të vjetër në një rast literatura e përdorur ish publikuar para 30 vjetësh dhe ishte për një lëndë që është dhënë si në sistemin parauniversitar.

Përfshirja e lëndës “Gjuhë shqipe dhe shkrim akademik” u gjykua si një pjesë e rëndësishme dhe integrale e një programi të tillë studimi. Ndonëse lënda është pjesë e kurrikulës parauniversitare, synohet të përmirësojë ndjeshëm aftësitë dhe kompetencat gjuhësore të studentëve të cilët vijnë me mungesa apo boshllëqe në këtë drejtim.

Në lidhje me literaturën, KPT e vlerëson dhe e mirëpret sugjerimin tuaj pasi me të drejtë ajo duhet të jetë sa më e përditësuar; për këtë KPT e ka vendosur si një kriter të vazhdueshëm në funksion të cilësisë. Në raste të caktuara mund të referohen literatura të një kohë të mëparshme për faktin se në atë literaturë është vendosur një standard i caktuar që i ka rezistuar kohës për një fushë studimi dhe që ka mbetur i tillë; por nga ana tjetër kjo nuk ka çenuar, referenca më bashkëkohore në ciklin e leksioneve.


Standardi 3.5 (kriteri 2) Sipas gjykimit të GVJ-së, ka lëndë të cilat mund të përmirësohen ndjeshëm. E të tjera që mund të evitohen fare siç mund të jetë lënda “Gjuha shqipe”. Programi studimor mund të pasurohet më tepër me lëndë menaxhimi apo komunikimi organizativ e ndërpersonal.

Përfshirja e lëndës “Gjuhë shqipe dhe shkrim akademik” është gjykuar të jetë një lëndë kyçe në formimin të studentëve në këtë program studimi duke patur parasysh që një pjesë e rëndësishme në punën e tyre është komunikimi, sidomos ai shkresor dhe komunikimi me mjete moderne digjitale si posta elektronike, mediat sociale etj. Nisur nga kjo, kompetencat dhe aftësitë e duhura në një komunikim të saktë gjuhësor nga ana gramatikore dhe leksikore është një kusht i qenësishëm. Thënë kjo, duke pasur parasysh që jemi pjesë e tregut të arsimit të lartë që nga viti 2015, ashtu si është evidentuar gjerësisht dhe në median e shkruar, studentët në përgjithësi vijnë me një bagazh tejet të cunguar në gjuhën mëmë; pra pavarësisht se gjuha shqipe është pjesë e kurrikulës së arsimit parauniversitar, dijet e cunguara bëhen një pengesë serioze për ta.

GVJ: Ne jemi të vetëdijshëm për mungesat e studentëve në lëndën në fjalë, pasi kjo reflektohet dhe në programe të tjera të IAL shqiptare, por si program universitar, sugjerojmë që lënda të mos mbetet e tillë. Nëse IAL, në bazë të studimit të tregut që do të realizojë apo dhe analizave të tjera të kontigjentit të ardhur të studentëve që do të bëjë, ka arritur në konkluzionin e dhënë në këtë shkresë se niveli i gjuhës shqipe është i dobët, atëhere mund të rishihen lëndët, mund të ofrohen kurse ose trajnime shitesë, apo mund të ndryshohet struktura e programit mësimor, pasi jemi dakord të gjithë, që në këtë profil, zotërimi i mirë i gramatikës dhe drejtshkrimit të gjuhës shqipe është i domosdoshëm. Vlerësojmë përpjekjet e IAL për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, por GVJ nuk e merr në konsideratë komentin e IAL.

8. KOMENTI I IAL: Standardi 4.1 (kriteri 2) Nga një shikim në portalin e ASCAL në datën (22/04/2021) këto informacione nuk janë karikuar akoma në sistem.

Sqarojmë se në datën 09.04.2021 në orën 13:26 janë ngarkuar në sistem evidenat e poshtë shënuara te kërkuara gjatë vizitës në institucion.



1. Studimi i tregut për këtë program studimi.
2. Rekorde komunikimi me studentët për regjistrimin e lëndëve në çdo semestër.
3. Lista e titujve të bibliotekës për programin e studimit.
4. Formulari i regjistrimit të lendeve të semestrit.
5. Për stafin akademik me kohë të pjesshme, për Dr. Curraj: Diploma BSC, njësimin nga MASR, vërtetimin e pages. Për librezën shëndetësore ka aplikuar pranë Mjekut të Familjes dhe është në pritje për tu pajisur përkatësisht, duke patur parasysh dhe kushtet e Pandemisë.

Për shkak të një pakujdesie, dokumentat janë ngarkuar në Shërbimin “Kërkesë për akreditim të programit të studimit "Administrim Zyre" në vend të shërbimit “Dokumentacion mbi akreditimin e programit të studimit Administrim Zyre”. Lutemi gjeni bashkëlidhur Evidencën 4 “Dokumenta shtesë në sistem” që e vërteton këtë. Duke kërkuar ndjesë, për çdo rast, i gjeni bashkëlidhur Evidenca 4 “Dokumenta shtesë në sistem”.

GVJ: GVJ pasi mori në shqyrtim evidencat shtesë i qëndron argumentit të mëparshëm për dosjen e zotit Curraj, e për pasojë nuk e merr në konsiderate komentit e IAL-së. Në lidhje me dosjen e tij, dokumenti i dorëzuar është vetëm një fotokopje e titullit të tij në gjuhën origjinale (greqisht), si dhe mungon njësimi nga MASR. Mungesë konsiderohet dhe librezë shëndetësore, pra dosja e tij për GVJ nuk është e plotë.

9. KOMENTI I KPT: Standardi 4.1 (kriteri 4) GVJ nuk arriti të merrte informacion se sa ishte buxheti i alokuar për kërkim shkencor, si ndahej ai sipas zërave dhe prioritetëve dhe në qfarë forme shpërndahej.

Gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ nuk është kërkuar një informacion të tillë. Sjellim në vëmendje që për shkak të natyrës së IAL, KPT i kushton vëmendje kërkimit shkencor të aplikuar në përputhje me natyrën e institucionit. KPT gëzon liri akademike në procesin mësimor, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. KPT garanton lirinë akademike që shprehet në respektimin e shumëllojshmërisë së opinionëve, ideve, metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e organizimit të saj.

Meqenëse Institucioni përkon me Nivelin 5 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, fokusi është në krijimin e specialisteve profesionistë me titullin “Teknik”. Megjithatë elementët e kërkimit shkencor janë të inkuoruar te procesi i mësimdhënies si dhe në marrëveshjet me IAL-të e tjera, ku është përcaktuar dhe kërkimi shkencor si fushë bashkëpunimi. Për këtë arsye, KPT nxit dhe stimulon çdo iniciativë për kërkimin shkencor dhe rritjen akademike të stafit, si dhe rritjen e cilësisë në arsim. KPT është pjesë e Konferencës së Rektorëve si një forum aktiv i koordinimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë.

GVJ: Saktësojmë që Kriteri 4, i referohet angazhimit të IAL për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit (jo studentëve). E për pasojë, edhe fjalia e nxjerrë në këtë shkresë i referohet një evidence të mundshme që mund të tregonte realisht dhe me fakte se si IAL e realizon këtë. Fjalia edhe mund të riformulohet, por shpjegimi në këtë shkresë, do të duhej t’i referohej se si IAL angazhohet të kualifikojë apo mbështesë stafin e tij. Për këto arsye GVJ i qëndron argumentit të tij fillestar për buxhetin e



alokuar për kërkim shkencor në funksion të stafit akademik, e për pasojë nuk e merr në konsideratë komentin e IAL-së”

10. KOMENTI I IAL: Standardi 4.5 (kriteri 5) Mungoi takimi me administratorin për të kuptuar më tej mbarëvajtjen e monitorimit të proceseve administrative.

Sqarojmë se në një takim i tillë nuk është kërkuar dhe as që i planifikuar në agjendën e vizitës së GVJ (lutemi gjeni bashkëlidhur Evidencën 5 “Agjenda”). Gjithashtu edhe gjatë vizitës në institucion nuk është kërkuar një takim i tillë nga ana e GVJ; Por në çdo rast konfirmojmë gadishmërinë tonë dhe mbetemi në dispozicion për të dhënë / vënë në dispozicionin tuaj çdo informacion të nevojshëm nga ana e administratorit.

GVJ: Komenti merret në konsideratë.

11. KOMENTI I IAL: Standardi (kriteri 1) GVJ nuk konstatoi të ekzistonte një model vendimi mbi ekuivalentim dhe transferim kreditesh, apo një rregullore e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Ne nuk kemi një rast konkret në lidhje me studentët e këtij program studimi, gjithsesi rregullorja për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve ekziston si dokument më vete i cili nuk është kërkuar gjatë vizitës në institucion. Lutemi e gjeni bashkëlidhur si Evidenca 6.

GVJ: GVJ edhe pasi u njoh me evidencat shtesë përsëri nuk është i bindur për plotësimin e këtij standardi, e për pasojë nuk e merr në konsideratë komentin e IAL-së”. Kjo pasi evidenca 6 e shtuar trajton pjesërisht rregulloren e transferimeve por nuk është e detajuar, ndërsa evidenca 6 fillestare ishte bosh dhe i referohet aneksit 5 në të cilin në nenin 31 pika 4 thuhet shprehimisht se: modalitetet e kësaj procedure përcaktohen në një rregullore të vecantë në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

12. KOMENTI I IAL: Standardi 5.4 (kriteri 3) GVJ referuar aneksit 46 mbi manualin e studentit, konstaton se KPT pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetës nga IAL e tjera vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve në IAL-të e tjera. Megjithatë GVJ nuk arriti të gjente një dokument që institucionalizon këtë proces.

Standardi 5.1 (kriteri 3) Nga dokumentet e depozituara në ASCAL konstatohet se nuk përmbahen materiale që dokumentojnë kërkesat e këtij kriteri. Në bazë të Ligjit 80/2015, Udhëzimeve të përvitshme të ministrit përgjegjës për arsimin, si edhe statutit institucional (nenit 59, pika 4) kriteret hartohen dhe propozohen nga njësitë bazë, miratohen nga Senati dhe i përcillen MASR-së dhe QSHA-së. Në asnjë aneks të depozituar nuk gjendet një dokument i tillë.

Në lidhje me këtë pikë sqarojmë se procedura dhe kriteret e pranimit të cilat miratohen nga Senati Akademik dhe janë paraqitur në raportin e GVB-së në seksionin Standardi IV. (kriteri 1), Standardi V.1 etj. Në përputhje me parashikimet ligjore, KPT njofton zyrtarisht me shkrim MASR dhe QSHA në lidhje me kriteret e pranimit për çdo vit akademik për çdo program studimi. Lutemi gjeni bashkëlidhur për ilustrim Evidencën 7 “Shkresë nr.Prot.


594/1, datë 29.1.2020 të KPT drejtuar MASR dhe QShA “Dërgohen kriteret e pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve për ndjekjen e programeve të studimit me karakter profesional për vitin akademik 2021-2022”. Këto kritere publikohen dhe përditësohen edhe në faqen e internetit të KPT shih <https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/>

GVJ: Komenti merret në konsideratë.

Nga konsultimi me prezencën në rrjetet sociale të subjektit, konstatohet se publikohen kriteret për pranimin në këtë kolegji. Nga konsultimi me aneksin 51 (politika e marketingut përmban informacion të pa kuptueshëm pasi nuk është e mundur të lexohet). Pra nga siti i KPT dhe aneksi 51 konstatohet se institucioni bën marketing të produkteve të tij lidhur me këto programe studimi, duke udhëzuar publikun. Në faqet e mësipërme sociale të subjektit, konstatohet një prezencë e mirë e udhëzimeve dhe orientimeve për të interesuarit.

Kërkojmë ndjesë pasi për shkak të një problemi teknik, dokumenti në fjalë është i skanuar me një cilësi të dobët në sistem. Dokumenti është dorëzuar edhe fizikisht në dosje, dhe për çdo rast lutemi e gjeni bashkëlidhur Evidenca 8 “Politika marketing”.

GVJ: Komenti merret në konsideratë pas ngarkimit të dokumenteve të reja.



Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Administrim Zyre”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Në vetë natyrën e IAL si një kolegji profesional, programi i studimit në “Administrim zyre” ofrohet si një cikël dy-vjeçar, i cili pajis studentët me aftësi teorike dhe praktike të përshtatura me tregun e punës. Sipas RVB dhe Strategjisë së Zhvillimit të KPT, 2015-2020, programi ofrohet dhe për të diversifikuar portofolin e ofertës akademike të IAL.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në dokumentin “Statuti i IAL”, Evidenca 2, specifikohen drejtimit prioritar të KPT. Këto objektiva, si dhe vizioni i IAL detajohen dhe më qartë në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të Institucionit”, Evidenca 3. Në këtë dokument cilësohet strategjia për tu rritur horizontalisht, ku KPT synon të ofrojë 12 programe studimi në specialitete si gazi, druri, etj, ku deri në momentin e realizimit të këtij dokumenti ofroheshin 9 të tillë (në Evidencën 4 listohen 10 të tillë, në Evidencën 5 Rregullorja e IAL i përfshin të 12 programet). Programi “Administrim Zyre”, si një ofertë e re e këtij IAL, nuk përmendet në strategji specifike. Në kërkesën dërguar Senatit Akademik të KPT, cilësohet dhe argumentohet që programi i studimit është i sugjeruar të ofrohet në përputhje me drejtimit dhe natyrën e IAL.
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	Në dokumentin “Plani strategjik për zhvillimin e programi” e KPT, konfirmohet që programi i studimit Administrim Zyre, ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ky program administrohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, për pasojë, qëndron tërësisht në përputhje me pëmbajtjen e programit mësimor të tij.
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Bazuar në RVB, konstatohet që analiza e parë që është bërë, i referohet asaj të Strategjisë së Zhvillimit 2015-2020, Evidenca 3, e pasuar nga “Propozimi për hapje programi të ri studimit”, Evidenca 4. Argumentet qëndrojnë, bazohen në të dhëna të përgjithshme dhe gjykime të asaj se çfarë kërkohet në realitetin e sotëm të menaxhimit të organizatave, por nuk ofrohet ideja e realizimit të një studimi të mirëfilltë mbi tregun lokal e kombëtar. Do të ishte ky studim që do të mund të ishte argumentimi kryesor i hapjes së programit të studimit, sic

	kërkohet në këtë kriter.			
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	Sipas dokumenteve të vënë në dispozicion, por edhe sic u konstatuar gjatë vizitës, IAL ka bërë disa përpjekje për të studiuar tregun e punës dhe për ta përshtatur kurrikulën deri diku sipas tij. Dokumentet e referuara dhe nga RVB (Evidenca 2 – Statuti, Evidenca 17 – Studimi i tregut) dokumentojne realizimin por nuk analizojnë qëllimet e aktiviteteve, rezultatet e tyre, si dhe si këto ndikuan duke modifikuar/përmirësuar/avancuar kurrikulën aktuale të programit të studimit.			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Ky kriter nuk plotësohet. Dokumentet e referuara në RVB i vlejnë programeve të “Teknologjisë së Ajrimit dhe Kondicionimit”, si dhe “Elektronikë”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësi e personelit, marrjes së përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që IAL i jep rëndësi ndarjes së detyrave mes njësi e personelit. Kështu, në Statutin e IAL, vërejmë organigramen e KPT, në të cilën RVB tregon përshtatjen me statutin. Programi i studimit, i menaxhuar nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, mbështetet dhe nga njësi ndihmëse si laboratorët, apo njësi të tjera si ajo e IT dhe Projekteve dhe Zyra e Karrierës, mbështetjes dhe informimit të studentëve. Në lidhje me analizën e vazhdueshme të punës, një pjesë e saj konstatohet të realizohet në qëllimet e Zyrës së Karrierës (referuar Rregullores së KPT).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënësit	Gjatë vizitës në IAL, si dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuar GVJ konstaton që KPT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër institucioneve dhe homologesh ndërkombëtare dhe vendas në funksion të ofrimit të mundësisë të shkëmbimit të dijeve. Sipas RVB, këto marrëveshje janë me tre IAL vendase (UPT, UAMD dhe UET si dhe në process me CIT), si

vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	dhe ka lidhur memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Thesalisë. Dokumentet përkatëse gjenden në Evidencën 34 të dokumenteve të dorëzuara nga IAL. Gjithashtu IAL ka një listë mjaft të gjerë punëdhënësish vendas (Evidenca 32), me të cilët konstatohet se kanë marrëdhënie të qëndrueshme vecanërisht në kryerjen e praktikave mësimore të studentëve.			
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Për këtë kriter RVB nuk mund të shprehet, ashtu sikundër dhe GVB në raportin e tyre, pasi praktikat realizohen në vitin e dytë dhe ende nuk kanë të dhëna.			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	IAL ka vendosur marrëdhënie të mira bashkëpunimi me punëdhënësit të ndryshëm (Evidenca 32 – Lista e partnerëve) për realizimin në terren të praktikave mësimore, nisur dhe nga një eksperiencë e mirë dhe me programet e tjera të studimit që ofron IAL.			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Për të mbështetur studentët në punësimin e tyre, apo në përgatitjen për të qenë më konkurrent në tregun e punës, KPT, me anë të Zyrës së Karrierës i orienton ata tek subjekte të ndryshme të interesuara. Gjithashtu studentët asistohen për realizimin e aplikimeve për punë, duke u orientuar si gjatë procesit mësimor, por edhe jashtë tij. Suksesit i këtyre iniciativave mbetet ende për tu analizuar, pasi sic edhe konstatojmë nga RVB dhe historiku i programit të studimit, nuk disponojnë ende të dhëna. Ne si GVJ jemi të mendimit që këto hapa janë të duhurit për të siguruar punësimin e studentëve, por sugjerojmë të ofrohen dhe mënyra të tjera të dedikuara për këtë program studimi. Konsiderojmë dhe mungesën e mobilitetit si pasojë e pandemisë, si një pengues mjaft të madh në realizimin e këtyre kriterëve, por pavarësisht kësaj, do donim të shihnim të realizuar në vizionin dhe planin e IAL edhe forma të tjera të afrimit të studentëve të programit “Administrim Zyre” me sipërmarrjen, menaxhimin e projekteve, administrimin e hapsirave dhe proceseve të biznesit, realizimin e raporteve, skedulimeve, tabelave financiare, analizave, etj., si disa prej aktiviteteve themelore të profilit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Në të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ, konstatohet që programi i studimit “Administrim Zyre” është organizuar në lëndë, të cilat vlerësohen me kredite në bazë të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, në bazë të Rregullores së IAL, lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese. Struktura dhe përmbajtja e programeve mësimore është në përshtatje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Programi i studimit “Administrim Zyre” përmban 120 ECTS dhe është i organizuar në dy vite akademike (4 semestra), ku cdo vit akademik ka 60 ECTS.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përftimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson programin e studimit “Administrim Zyre” si një program me karakter teorik dhe praktik, gjë që realizohet në një kohë të shkurtër sipas strukturës mësimore. Në Evidencën 4, Plani strategjik për zhvillimin e programit, konstatohet që një i diplomuar në këtë program studimit mund të shërbejë në pozicione të ndryshme brenda një organizate, duke qenë se plotësohet me “soft skills” dhe aftësi praktike.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Këto duken të pasqyruara dhe në strukturën e programit të studimit, në ofrimin e lëndëve dhe përmbajtjes së një pjesë prej tyre (Evidenca 7).</p> <p>Evidenca 14, Dosja e Plotë e Programit të Studimit me elementët përbërës të tij, përmban tabelën e lëndëve sipas 5 kategorive të tyre (A-E), si dhe tabelën e programit të studimit për vitin akademik 2020-2021. Në bazë të ndarjes së lëndëve në kategori, GVJ konstaton që ka një ekulibër të mirë mes tyre, si dhe një ndarje të mirë konceptuale, sipas tre aftësive kryesore që programi i studimit tendon të mbulojë: aftësitë informatike (6 lëndë), ekonomiko-ligjore (6 lëndë), dhe administrative (rreth 4 lëndë). Lëndët kanë shpërndarje të ndryshme të ECTS, ku praktika profesionale ka ngarkesën më të madhe (10 ECTS) dhe diploma/provimi i formimit ka 7 ECTS. Po kaq vëmë re që ka dhe lënda Menaxhimi i arkivave, gjë që për GVJ duket se është i lartë, por është IAL që e arsyeton dhe vendos këtë vlerë.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Konceptimi i strukturës mësimore shohim që ofron orientimin e duhur për studentët, duke ua bërë atyre më profesionale qasjen ndaj situatave të ndryshme në punë.</p> <p>Disa komente në lidhje me përmbajtjen e lëndëve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shkrim akademik dhe gjuhë shqipe (në strukturë emërtimi është Shkrim Akademik/Gjuhë shqipe, që nënkupton në pamje të parë që këto lidhen me lidhëzën “ose”) në përmbajtjen e syllabus ofron vetëm Gjuhë Shqipe dhe nuk gjendet asnjë temë që t’i referohet Shkrimit akademik (temat kanë të bëjnë me sintaksën dhe drejtshkrimin e gjuhës shqipe). Syllabus nuk ka asnjë informacion se si do të zhvillohen dhe se çfarë përmbajnë orët laboratorike, për të cilët studentët do të marrin 30 pikë.

	<p>Kjo vlen për një pjesë të mirë të lëndëve që kanë vlerësim për këtë pjesë.</p> <p>2. Të rishihen kreditet e lëndës Menaxhimi i Arkivave.</p> <p>3. Lënda “Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit”, nëse është përshtatja nga gjuha angleze për Management Information Systems, sugjerohet të përkthehet si “Sisteme Informacioni të Menaxhimit”</p> <p>4. Bazat e Informatikës, Gjuhë shqipe, etj figurojnë dy herë për dy vitet akademike në listën e syllabus të lëndëve; ndërkohë që mungojnë syllabus të disa lëndëve.</p> <p>5. Literatura është në përgjithësi e vjetër, sugjerojmë të përditësohet për të gjitha lëndët.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Në bazë të evidentimit të bërë nga ASCAL, në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, në datë 28.10.2020, rezultojnë 11 anëtarë, nga të cilët 3 janë me titull Profesor, dhe të tjerët me titull Master. Në lidhje me verifikimet e bëra nga ASCAL, përgjegjësi i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, si dhe rektori, janë mbi limitin e moshës së lejuar për punësimin me afat të pacaktuar, gjë që bie ndesh me përcaktimet e Ligjit të Arsimit të Lartë.</p> <p>Sipas RVB, në këtë departament janë përfshirë 11 anëtarë të ftuar, nga të cilët 1 me titull Prof. Asoc. Dr. dhe dy me titullin Dr.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi i studimit e ka të qartësuar në Rregullore (Evidenca 7) objektivat e formimit profesional të studentëve. Këto shihen të reflektuara dhe në programet e vecanta lëndore të programit të studimit. Kështu, sipas këtyre evidencave, program fokusohet në aftësim kompjuterik, ekonomiko-ligjor dhe administrativ.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plot përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Plot përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Sipas dokumenteve të dorëzuara nga IAL pranë ASCAL, GVJ vëren që në Evidencën 14, referuar si Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij, rezultojnë vetëm dy tabela të detajuara të ndarjes së lëndëve në kategori (Tabela 1) dhe ndarja e tyre në semestral (Tabela 2). Pavarësisht kësaj, në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit janë formuluar objektivat për formimin profesional të studentëve, si dhe janë cilësuar këto objektiva në syllabuset e vecanta. Sugjerojmë që programi i studimit të ndahet si dokument i vecantë, që të përmbajë të gjithë përshkrimet e nevojshme për degën Administrim Zyre, dhe rregullatori të jetë procedural.
Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.	RVJ konstaton që plani mësimor i programit të studimit "Administrim Zyre" përmban një pjesë të rëndësishme të informacionit në lidhje me orët mësimore të çdo lënde përgjatë viteve të studimit; numri i ECTS, tipologjia e lëndëve (kategoritë A-E). Çdo lëndë vlerësohet 40% gjatë vitit dhe 60% në provimin final. Në programin mësimor vërehet që janë vendosur dhe orët e dedikuara të laboratorit, si dhe nga kontrolli i syllabuseve, nga vizita në institucion, si dhe nga takimi me studentët konfirmohet bërja e punëve praktike në laboratorë gjatë orëve të seminarit. Këto ndarje ndjekin përcaktimet ligjore vendase, si dhe paraqesin një raport të mirë të teorisë me praktikën.
Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.	Informacioni i kërkuar në këtë kriter gjendet në Rregulloren e Programit të Studimit, ku përfshihen detaje në lidhje me strukturën mësimore. Gjithashtu, syllabuset ndjekin një format të tillë që i përcakton serish këto detaje. Sipas konstatimit të GVJ, në një pjesë të këtyre syllabuseve nuk jepen detaje se çfarë vlerësohet në orët e ushtrimeve apo laboratorëve. Ky informacion i shërben GVJ për të kuptuar më mirë metodologjitë e ndjekura në klasë, për të kuptuar nëse zhvillohen projekte, detyra kursi, në mënyrë individuale apo në grup, nëse zhvillohen raste studimi, simulime, aktivitete, etj, që plotësojnë më tepër ose jo aktivitetin praktik e profesional të programit të studimit.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.	
Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.	GVJ konstaton që struktura dhe organizimi i programit të studimit janë fleksibël, ato mbulojnë aspekte të rëndësishme profesionale të administratorëve të ardhshëm të zyrave, si dhe punës praktike i është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, si dhe në programet e vecanta lëndore. Do të sugjerohet në këtë kriter që përmbajtjet të përditësohen me tema dhe literature më bashkëkohore, të futen koncepte më të
Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha	

e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	aktualizuara (si p.sh. marketing dixhital, fintech, siguria e personelit, të të dhënave dhe informacionit, një lëndë e dytë për etikën dhe komunikimin, etj, sipas kurrikulave ndërkombëtare të programeve të ngjashme profesionale).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Lëndët dhe modulet e ofruara në programin e studimit Administrim Zyre janë emërtuar dhe strukturuar sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi. Ky program, që klasifikohet si i Kategorisë 5, është i ndërtuar në dy vite akademike dhe ka në total 120 kredite. Konstatohet që ky program ndjek dispozitat e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), e reflektuar në Statutin e IAL dhe Rregulloren e Programit të Studimit (Evidenca 7).
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	GVJ vëren që ky program është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit tonë, është i përshtatshëm për vendet e punës të ofruara në fushën e administrimit, por nevojitet të saktësohet më shumë brenda programeve lëndore në lëndë të vecanta aftësitë praktike dhe qasjet, nga të cilat do të përfitojë studentit.
Kriteri 3. Planin mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	Në kriteret e kaluara GVJ ka përmendur konstatime të ndryshme në lidhje me programin, syllabuset dhe elementët përbërës të tyre që sugjerohet të rregullohen apo shtohen.
Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.	Raporti Teori Praktikë, i përlogaritur si raporti: (orë totale leksioni + orë totale seminari) / (orë Lab + Ushtrime + praktike + tjetër), në programin “Administrim Zyre” nëse përlogaritet në bazë të dokumentit “Plani Mësimor”, do të figurojë që :
Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	TOTAL: 120 ECTS Praktika + Provim pranimi: 17 ECTS Lëndët: 103 ECTS Leksion 59 ECTS; Seminare 44 ECTS Për ta përmbledhur, GVJ konstaton se ka një raport të

	<p>përshtatshëm në ndarjen e veprimtarive formuese. Gjithashtu, natyra praktike e profilit saktësohet qartë dhe në syllabus-et e lëndëve, në të cilat saktësohen orët në laborator dhe punët praktike.</p> <p>Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese të paraqitura në Rregulloren e Programit të Studimit dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit në përshtatje me pritshmëritë e IAL, por ende të pakonfirmuara drejt me atë që kërkon tregu i punës.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Në mungesë të një dokumenti përmbledhës e përshkruar të programit të studimit, GVJ arrin të konstatojë të dhëna rreth tij duke sintetizuar disa prej dokumentave të dorëzuar nga IAL (Evidenca 4 dhe 7).
Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehitë e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	Programi i studimit i plotëson kërkesat e profesionit në një masë të kënaqshme, orienton studentët mirë drejt njohurive kryesore të administrimit të një zyre, si dhe i aftëson ata drejt një komunikimi sa më të mirë.
Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	Në listën e lëndëve të ofruara konstatohet prania e lëndëve të rëndësishme për aftësimin praktik të studentëve (Kategoria B dhe C), por edhe të aspekteve menaxheriale e komunikuese, që në këndvështrimin tonë orientojnë si duhet në përvojën e punës.
Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	Sipas RVB, lëndët e programit të studimit janë të përshtatshme dhe i plotësojnë kërkesat e profesionit, ato parashikojnë zhvillimin e aftësive të transferueshme, por nuk cilësojnë se si arrihet kjo, apo si matet. Për rrjedhojë, edhe GVJ nuk mund të konstatojë nëse një kriter i tillë plotësohet.
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e	Një nga elementët e spikatur të programit të studimit është praktika profesionale, të cilët studentët e kanë zhvilluar pranë

<p>vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>subjekteve të ndryshme private apo publike (shoqara të mëdha, biznese, industri të ndryshme, OJF, studio ligjore, zyra të tjera). Sipas RVB, praktika ndiqet nga përgjegjësi i departamentit – i cili përcakton dhe pedagogët që do të ndjekin studentët individualisht, në bashkëpunim me Zyrën e Informacionit dhe mbështetjes së studentëve. E rëndësishme për tu theksuar është fakti që student nuk mund të diplomohet nëse nuk shlyen praktikën profesionale.</p> <p>Për të verifikuar dhe certifikuar pjesëmarrjen e plotë në praktikën mësimore, kolegji harton një relacion me informacion rreth njohurive që studenti ka marrë në praktikë dhe vlerëson më pas studentin me notë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p>Standardi III.1</p>	
<p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar (Evidenca 8, Rregullore e NJSBC), raportit RVB, si dhe gjatë vizitës në IAL, GVJ u njoh me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në KPT, si strukturë e posaçme e monitorimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë strukturë qëndrojnë kryetari i njësisë, një përfaqësues nga pedagogët e cdo departamenti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, një përfaqësues nga studentët dhe një ekspert i jashtëm.</p> <p>Sipas kërkesës së kriterit, në Evidencën 8, GVJ konstaton që rezultatet e NJSBC publikohen në një raport që i dërgohet rektorit, përgjegjësve dhe administratorit (Pika V.5.6), pra procedura nuk i bën këto rezultate publike.</p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies,</p>	<p>Format e mësimdhënies e mësimnxënies në KPT për</p>

mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.	programin e studimit “Administrim Zyre” përfshijnë: leksione, ushtrime, laborator/praktikë. Nuk konstatohet në RVB, apo dhe në syllabuset e vecanta të programit, nixtja për të realizuar detyra përgjatë lëndëve si projektet, essetë, detyrat e kursit, etj. Sugjerojmë që këto vlerësime të semestrit, në rastet kur ato realisht kryhen, të jenë pjesë e syllabuseve dhe dokumenteve të tjerë (sidomos atë të Strukturës së programit të studimit).			
Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	Në varësi të lëndës, personeli akademik përdor forma e metoda të ndryshme të mësimdhënies. Me këtë GVJ u njoh gjatë vizitës, ku pati mundësinë të vrojtonte nga afër ambjentet e klasave, të laboratorëve të ndryshëm, si dhe sallat me kompjuter. Zyra e IT na informoi për programet e ndryshme softuerike, si dhe pajisje të tjera si projektorë, etj.			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.	Pasi u shqyrtuan CV e stafit akademik të programit të studimit (Evidenca 20), si dhe duke iu referuar syllabuseve u konstatua që personeli akademik i angazhuar është kompetent në njohuritë dhe konceptet e fushës.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Sipas RVB, institucioni suporton stafin akademik në rritjen e mëtejshme profesionale dhe i nxit ato të marrin pjesë në seminare, mbledhje apo forume të ndryshme. Një prej tyre është masterklasa “Entrepreneurial University Programme” nga EU for Innovation (Evidenca 60).			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Sipas RVB, Kolegji Profesional i Tiranës, ndodhet në një seli ku zotëron 2.500 m ² . Gjatë vizitës, GVJ konstatoi që ambjentet ishin me hapsira të mjaftueshme, me klasa të pajisura me mjete që e lehtësojnë mësimdhënien, si dhe me laboratorë të mjaftueshëm për realizimin me cilësi të procesit mësimor. Këta laboratorë ishin të pajisur me programet softuerike të lëndëve të vecanta të IT, si MS Office, MS Teams, Photoshop CS6, Etrum, ËAMP).
Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në	Për të plotësuar elementët teknologjikë, IAL ka vënë në

dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	dispozicion faqen zyrtare, postën elektronike, sistemin Claster, etj. Mund të themi që niveli i informatizimit të proceseve të ndryshme si të mësimdhënies, ashtu dhe të administrimit, ishin në nivele mjaft të kënaqshme.			
Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Këto ambiente janë shfrytëzuar nga stafi dhe studentët për kryerjen e detyrave të ndryshme.			
Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Sic e kemi përmendur në kriteret më lart, një nga sugjerimet kryesore të GVJ në lidhje me programet lëndore, është rifreskimi i literaturave të rekomanduara. Gjatë vizitës, u konstatua që biblioteka e IAL ishte e zhvendosur përkohësisht (si pasojë e rregullimeve prej tërmetit të nëntor 2019), e për pasojë ishte jashtë funksionimit.			
Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Në RVB, përmendet që studentët mund të aksesojnë biblioteka online, por nuk përmendet se cilat janë ato ku studentët kanë të drejtë akses. Gjithashtu përmendet që IAL përdor bazën materiale të një IAL tjetër, sipas një marrëveshjeje mes tyre.			
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Për realizimin e mësimin online, IAL ka mundësuar platformën MS Teams, e shfrytëzuar që nga semestri i dytë i vitit akademik 2019-2020 e deri në vazhdim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga IAL (Evidenca 8, 12, 13), si edhe gjatë vizitës së zhvilluar, u bë e mundur prezantimi me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NJSBC vlerëson periodikisht procesin mësimor, si dhe proceset administrative. Kjo njësi rezulton si autonome, por ndërvepron ngushtësisht dhe me shumë njësi të tjera të IAL (Departamenti i Teknologjisë, Njësia e monitorimit të Kurrikulës, etj).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse	Departamenti i Teknologjisë, pranë KPT, është përgjegjës

<p>për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>për procesin e mësimdhënies në degën “Administrim Zyre”, për përmirësimin e cilësisë dhe vetëdijësimin të personelit. Sipas komunikimeve të bëra gjatë vizitës në IAL, NJSBC vlerëson pedagogët cdo semestër, e madje në një rast kanë pasur një rast përjashtimi.</p>			
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Gjithashtu, gjatë vizitës në IAL, në takim me personelin akademik si dhe me përfaqësues të tjerë të njësive të ndryshme, u vu re angazhimi i tyre për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, apo në rritjen e cilësisë së pjesës praktike të programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>IAL suporton stafin e tij, si dhe njësitë përgjegjëse për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Stafi u shpreh për këtë support gjatë vizitës së GVJ, gjë që tek ata ka nxitur kualifikimin e mëtejshëm.</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e prishmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjithashtu IAL rezultoi fitues në 4 projekte: 1) Bazat e digjitalizimit të BË (Jean Monnet); 2) Erasmus+; 3) Engine; 4) Usia. Këto eksperiencë i kanë ndihmuar personelet akademike të përmirësojnë aspektet e tyre të mësimdhënies. Pavarësisht vitit pandemic, nuk na rezultoi që personeli raportoi në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat përgjegjëse.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.4

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ referuar aneksit 7 mbi “Rregulloren e programit të studimit të natyrës profesionale në “Administrim zyre”, neni 8, fq.4 afirmohet se provimet realizohen në shkrim, me gojë ose në mënyrë të kombinuar. Vlerësimi bëhet me pikë nga 0-100 dhe me notë nga 4 (katër) deri në 10 (dhjetë) pika 2 e neni 8 afirmon se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm.</p>
<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve</p>	<p>GVJ kostatoi nga syllabuset e përfshira në programet e</p>

dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	aplikuara për akreditim, se vlerësimi në çdo lëndë bëhet me anë me detyrave të kursit për të, ballafaquar kompetencat dhe aftësitë e fituara me aplikimin e tyre në praktikë, testim i ndërmjetëm (kolegium) si dhe vlerësim në provimin final.			
Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	Nga takimi me studentët GVJ po ashtu kostatoi se studentët njiheshin me formën e vlerësimit që në ditën e parë që fillonte moduli/lënda. Nga takimi me pedagogët u pohua se syllabusi shpërndahe në masën 100% tek studentët.			
Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua kryesisht aneksit 7 dhe 19 të depozituar në ASCAL, intervistave me pedagogët që lëvrojnë syllabuset në KPT, si edhe intervistave me studentët e këtij koleji. Nga syllabuset e depozituara konstatohet se pothuajse të gjitha lëndët e lëvruara kanë një strukturë vlerësimi: a) 10% frekuentim; b) 30% testim sezonal dhe detyra kursi; c) testim përfundimtar me shkrim 60%. Nga intervistat me pedagogët dhe studentët u konfirmua verbalisht një sistem i tillë vlerësimi dhe ruajtja e plotë e anonimitetit me anë të sekretimit duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit deri në momentin e korigjimit të provimit.			
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Për vlerësimin e këtij kriteri, grupi i ekspertëve tentoi t'i referohej rregullores për zhvillimin e provimeve (aneksi 5), neni 47 studentet vlerësohen nga pedagogu i lëndës dhe nga asistenti i tij. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të provimeve në sekretarinë mësimore të subjektit, konstatohet se këto procesverbale firmosen nga titullari i lëndës, përveç firmave proceduriale që ishin ajo e dekanit (jo përgjegjësit të departamentit) dhe e sekretares.			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.	Nga intervistat me studentët dhe pedagogët, sikurse edhe vizita në sekretarinë mësimore, procedura e raportimit dhe dokumentimit të vlerësimit në regjistrat përkatës duket e rregullt në pikëpamje kohore. Ky kriter, i cili ezaurohet shkresërisht në rregulloren e provimeve, ekspertët u njohën me aneksin 5 dhe 7. Nga takimet me studentët, ata u shprehën se nuk ekzistojnë problematika në lidhje me njohjen e vlerësimit dhe rishikimin e tij sipas kërkesave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfundimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxëniet për programet me karakter profesional.	Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ iu referuan anekseve 7 & 14 që përmbanin rregulloren e programit të studimit për akreditim nga ana e subjektit. Po kështu, u konsultua aneksi 16 (studimi i tregut për programin e studimit), aneksi 19 (kurrikula, plani mësimor dhe syllabuset e programeve) dhe aneksi 17 (punësimi mbas daljes nga bankat e shkollës). Nga sa më lart, referuar të dhënave të përmbajtura në aneksin 19, rezultoi se programi i studimit realizohet përmes një literature që përdoret gjerësisht në fushën e IT dhe jo për Administrim Zyre që duhet të kishin më shumë lëndë menaxheriale dhe ekonomike. Në mjaft raste, syllabuset kishin një literaturë shumë të vjetër në një rast literatura e përdorur ish publikuar para 30 vjetësh dhe ishte për një lëndë që është dhënë si në sistemin parauniversitar. Duke iu referuar anekseve 16 & 17, vërehet se analiza e tregut të punës nuk ishte e tillë kishte vetëm foto dhe informacione të përgjithshme, ndërsa nuk kishte një analizë për tregun e punës të bërë mbas daljes në tregun e punës se ishte brezi i parë ende i pa diplomuar .
Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.	Kurrikula e programeve (aneksi 19) përmban lëndë të disiplinave të ndryshme. Konstatohet se në mjaft lëndë përdoret me përparësi teknologjia e informacionit për aksesim, grumbullim, përpunim, analizim, konkludim dhe programi të dhënash. Nga intervista me pedagogët dhe studentët u pohua se lëndët teknologjike janë të nevojshme edhe për administrimin e zyrës edhe pse me siguri nuk do të meren me programim në të ardhmen. Sipas gjykimit të GVJ-së, ka lëndë të cilat mund të përmirësohen ndjeshëm. E të tjera që mund të evitohen fare siç mund të jetë lënda “gjuha shqipe”. Programi studimor mund të pasurohet më tepër me lëndë menaxhimi apo komunikimi organizativ e ndërpersonal.
Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur	Nga syllabuset e konsultuara, nga takimet me pedagogët dhe studentët, sikurse edhe inspektimi i infrastrukturës teknologjike të subjektit konfirmohet aplikimi i njohurive në laboratorë dhe praktika profesionale, për aq sa e lejojnë disiplinat e parashikuara për t’u lëvruar. Gjithashtu, stafi akademik i KPT për këtë program përbëhet nga profesionistë të fushave përkatëse, një garanci më tepër kjo se



format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.	mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash.			
Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.	Nga konsultimi me aneksin 19, shumica e syllabuseve e depozituara në ASCAL përmbajnë një temë të posaçme (zakonisht temën e fundit të lëndës) për përsëritjen e njohurive dhe orientimin për provimin përfundimtar. Nga takimi me studentët u konfirmua vlefshmëria e një orientimi të tillë.			
Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.	GVJ referuar aneksit 2 mbi Statutin aneksit 5 për rregulloren dhe 10 mbi rregulloren e diplomimit (bosh) nuk është në gjendje të japi një vlerësim për këtë kriter si për mungesë dokumentacioni referues si dhe pasi ky program studimi nuk ka nxjerrë akoma brezin e parë të të diplomuarve. Kjo gjë e bën të pa mundur përgjigjen për këtë kriter.			
Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	Sikurse theksuar në kriterin 5 më lart GVJ nuk është në gjendje të japi një vlerësim për këtë kriter. Pasi është grupi i parë i studentëve dhe nuk ka të diplomuar për të vlerësuar këtë kriter.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive nga ana e tyre

Kriteret	Vlerësimi
-----------------	------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Nga intervistat me pedagogët që lëvrojnë kurrikulën e programit të aplikuar për akreditim, konsultimin me aneksin 20 & 29 dhe tabelat përmbledhëse depozituar në ASCAL, sikurse dhe konsultimin me dosjet e stafit akademik në zyrën e burimeve njerëzore, procedura e rekrutimit përsa i përket specifikimeve të kriterëve dhe përputhjes me vendin e synuar të punës, duket në përputhje me objektivat e institucionit dhe programin për të cilin kërkohet akreditim. Konkretisht, në përputhje me nenin 59, pika 6 e Ligjit 80/2015 dhe nenin 22, pika 5 e statutit institucional, të gjithë pedagogët e angazhuar në programin e aplikuar për akreditim mbajnë gradë minimalisht të ciklit pasardhës kundrejt programit ku janë angazhuar në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 20, sikurse dhe vizitën në zyrën e burimeve njerëzore pranë institucionit, GVJ konstaton se, nga përzgjedhja rastësore e dosjeve për anëtarët e stafit akademik, të dhënat për anëtarët e personelit akademik janë gjithmonë të plota dhe të përditësuara. Në njërin prej dosjeve ka mangësi dokumentacioni që u pranua edhe nga përgjegjësja e burimeve njerëzore e cila u zotua se do ta sillte si informacion në vijim. Ky dokument u shtua në sistem në ditët në vijim dhe ishte i plotë, konform rregullave.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 20, 23 & 24, sikurse edhe nga takimi me pedagogë dhe drejtues të subjektit, detyrimi ligjor për raportin 70/30 në përqindje të pedagogëve të brendshëm kundrejt atyre të jashtëm (cilësuar në VKM nr. 418, dt. 10.05.2017, pika 2, gërma "b", niveli "ii" dhe pohuar i plotësuar në raportin e RVB-së në fq. 36 të tij) nuk plotësohet. Ky fakt u pohua nga dekani i Përgjegjësi i Departamentit, i cili e vlerësoi këtë raport në nivelin 50/50 në favor të pedagogëve të brendshëm të institucionit. Pra vetëm 50% e lëndëve mbulohet nga personeli akademik me kohë të plotë. Referuar të dhënave tabelore të aneksit 23, stafi akademik përgjegjës për programin e studimit në fjalë, përbëhet nga 17 pedagog, nga të cilët 6 janë pedagog efektiv (PAE) nga të cilët njëri mban titullin Prof. Dr. 4 mbajnë gradën MSc dhe një mban gradën MND si dhe 11 janë pedagog me kontratë (PAK), nga të cilët 1 mban titullin Prof. As., një gradën Dr., një mban gradën MP dhe 8 mbajnë gradën MSc.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të</p>	<p>Nga aneksi nr. 43 është e pamundur të konkludohet se si e përmbush institucioni angazhimin e tij përsa i përket kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik që mbulon dhe administron programin e studimit. Konkretisht, aneksi 43 mbi aktivitetet për kualifikim shkencor në 5 vitet e fundit, rezultojnë se vetëm njëri prej stafit akademik ka arritur të përfitojë gradën MSC në 2018. Nga inspektimi në terren</p>

teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	i mjediseve të fakultetit (biblioteka) konstatohen investime të qenësishme për rritjen potenciale profesionale të personelit. GVJ nuk arriti të merrte informacion se sa ishte buxheti i alokuar për kërkim shkencor, si ndahej ai sipas zërave dhe prioriteteve dhe në çfarë forme shpërndahej.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga inspektimet në terren dhe bisedave me studentët, kriteri plotësohet në përputhje me kërkesat ligjore (VKM nr. 418, dt. 10.05.2017 dhe Udhëzimit nr. 1, dt. 14.01.2020 të titullarit të MASR) dhe madje tejkalohet. Në përputhje me risqet më të fundit të pozura nga tërmeti dhe pandemia, institucioni ka marrë masat e duhura antisizmike dhe distancimit fizik dhe higjienës së shtuar.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Referuar vizitës në terren dhe njohurive specifike të ekspertëve të jashtëm, kërkesat e këtij kriteri plotësohen dhe tejkalohen në terma absolutë dhe relativë nga subjekti kandidat për akreditim në këtë program. Infrastruktura hard e subjektit është bashkëkohore, e licensuar konform ligjeve dhe në përputhje me nivelin e njohurive të stafit akademik e ndihmës akademike. U konstatua një numër i mjaftueshëm kompjuterash, projektorësh, sisteme audio dhe routerash për lidhje në Internet.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga inspektimi në terren u konstatuan pajisje të licensuara për kryerjen me sukses të programit mësimor. Kompjuterët si dhe pajisjet e ndryshme teknike janë të parametrave optimale për nevojat e punës dhe mësimdhënies.
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Nga inspektimi në terren vërehet se subjekti ka 4 laboratorë të pajisur më së miri në këtë drejtim, për programet për të cilat ka aplikuar për akreditim. Po ashtu ka një liste me 6 Open Source dhe Soft Grafic Design.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në	Institucioni ndodhet në një godinë, ku zhvillohet aktiviteti në të

bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	cilën sallat janë të pajisura me të gjitha hapësirat, aparaturat dhe dijen e nevojshme të stafit për t'i operuar ato në funksion të mësimdhënies, praktikave profesionale dhe çdo aktiviteti tjetër me natyrë akademike, profesionale e praktike. Gjithashtu ka një sërë marrveshjesh bashkëpunimi me kompani të sektorit privat si Make Ëith IC, Albtelecom, Bashkia Tiranë etj., ku studentët mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi IV.3				
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Nga inspektimi në terren i mjediseve të subjektit, konstatohet se KPT disponon dhe vë në dispozicion të studentëve 1 bibliotekë mësimore brenda mjediseve të tij, sikurse edhe bibliotekën virtuale, ku stafi akademik dhe studentët mund të konsultojnë një numër të madh artikujsh në formatin elektronik.			
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Nga inspektimi në terren, konstatohet se kërkesat e këtij kriteri për tipet e ndryshme të literaturës fizike dhe pasurimin e literaturës në mënyrë të herëpashershme përmbushen plotësisht. Problemi në këtë drejtim qëndron tek niveli i ulët i shfrytëzimit të tyre nga ana e studentëve, për shkak të numrit dhe interesit të vakët kërkimor e profesional. KPT, sikurse është cituar vazhdimisht më lart, disponon dhe ofron akses online për studentët e tij në disa faqe elektronike që shërbejnë si biblioteka virtuale, të cilat u ofrohen pa pagesë studentëve të programit të studimit.			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nga dokumentet e konsultuara nuk identifikohet një plan i tillë i detajuar, por aneksi 31 paraqet në formë tabelare një raport mbi përditësimet dhe periodiket në bibliotekë si dhe akses në disa faqe elektronike.			
Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit	Referuar evidencave 32 dhe 34 mbi partnerët dhe marrveshjet me IAL-të e tjera si dhe referuar ambienteve të KPT mund të afirmohet se kolegji në fjalë ka në dispozicion infrastrukturën e			

mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.	nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik.			
Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	GVJ referuar aneksit 50 faqe nr.3 afirmon se kosto për një student është parashikuar 1800 euro. Referuar aneksit 49 vërehen të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit GVJ vlerëson se KPT garanton qëndrueshmëri financiare me qëllim zhvillimin normal të veprimtarisë mësimore.			
Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.	GVJ referuar anekseve 49 & 50 afirmon se KPT siguron dhe garanton mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme, që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim. Edhe pse në programin në fjalë ka pak të regjistruar KPT e mbulon këtë program studimor me të ardhurat e tjera që gjeneron përgjatë një viti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ në aneksin 2 kostatoi se KPT për t'u pranuar në Programin e studimit me karakter profesional " Administrim Zyre" ka përcaktuar se studentët duhet të kenë përfunduar gjimnazin. Ata duhet të dorëzojnë listën e notave, dhe fotokopje të noterizuar të diplomës. Pranohen gjithashtu edhe studentë që transferojnë studimet nga një kolegji në tjetrin. GVJ kostatoi po ashtu nga aneksi 2 se Senati Akademik përcakton çdo vit kriteret e pranimit të studentëve në KPT. Vlerësimi i dijes, dhe pocesi akademik në këtë kolegji përcaktohet qartë në rregulloren e KPT (anekset 5,7,9).
Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e përgjithshme dhe/ose të veçanta për	Nga konsultimi me anekset 4, 5, 7, 9, dhe faqen online të subjektit, https://kolegjiprofesional.edu.al/ , konstatohet se janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi: Statuti,

<p>pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Rregulloret, Plani Strategjik dhe dokumentet shkresore mbështetëse, si edhe formularët e punës (template) për dizenjimin dhe monitorimin e politikave dhe procedurave.</p> <p>Gjurmët e zbatimit të këtyre politikave konfirmohen nga vizita në sekretarinë mësimore, sikurse edhe biseda me kampionin e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Nga konsultimi me syllabuset e lëndëve (aneksi 19), konstatohet se në rubrikën e vlerësimit të dijeve përmbahen të plota procedurat për përparimin akademik në vitin mësimor, sikurse edhe për avancimin midis viteve akademike. Në aneksin 57, përcaktohet qartë zhvillimi i praktikës mësimore si edhe nga takimi me pedagogë e studentë, konstatohet se studentët kanë plotësisht mundësinë të informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre. Informacioni është i publikuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për këtë qëllim.</p>			
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga konsultimi me anekset 7, 14, si dhe aneksin 19, studentët kanë mundësinë të informohen hollësisht për detajet e programit të studimit të përzgjedhur. Nga takimi me studentët konfirmohet një informim i tillë paraprak. Po ashtu në këtë IAL ka një zyrë karriere e cila i informon studentët vazhdimisht për mundësitë e punësimit apo për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 19, konstatohet se syllabuset, kurrikula dhe plani mësimor përmbajnë në detaje informacionin për veprimtaritë akademike, praktike e profesionale të parashikuara. Po ashtu studentët konfirmuan se pedagogët në leksionin e parë shpjegon si do të organizohet lënda, modulu, veprimtaritë që do të zhvillohen dhe si do të organizohet procesi mësimor.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga takimi me stafin dhe studentët, u konstatua se, edhe për shkak të pandemisë, informacioni është lehtësisht i disponueshëm edhe në distancë, sikurse i gjurmueshëm nga të gjitha strukturat menaxheriale të përfshira (pedagogët për mësimdhënien, NjSBC për kontrollin dhe sekretaria e administrata për regjistrimin dhe raportimin).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Për vlerësimin e këtij kriteri, ekspertët konsultuan kryesisht anekset 51, 52, 58, 60 nga dokumentet e depozituara në ASCAL, statutin e institucionit nga faqja online e tij dhe vizitën në sekretarinë mësimore. Nga sa më lart rezulton se institucioni ka ngritur të gjitha strukturat e nevojshme menaxheriale të drejtimit akademik dhe administrativ në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e dala në zbatim të tij. Këto struktura administrojnë informacionin akademik i cili, nga konspektimi i regjistrimit të studentëve, mbahet i plotë, me kujdes dhe në përputhje me proceverbalet e lëndëve përkatëse; sikurse administrojnë edhe informacionin administrativ, që përmban kontratën me studentin, numrin e matrikullimit dhe dokumente të tjera të natyrës administrative e financiare. Ruajtja dhe përditësimi i këtyre informacioneve bëhet manualisht dhe elektronikisht, në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe statutin institucional. GVJ kostatoi po ashtu se përsa i përket analizës për tregun e punës, kjo nuk është e plotë.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentave të mësipërme dhe vizita në drejtorinë e burimeve njerëzore brenda institucionit konstatohet se menaxhimi i brendshëm mban një dokumentacion të plotë të stafit akademik dhe jo akademik, sikurse edhe pedagogëve të ftuar për realizimin e programit. Ky dokumentacion ruhet manualisht dhe elektronikisht, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga testimi që iu bë përgjatë vizitës së ekspertëve aksesimit të informacionit dhe nivelit të këtij aksesimi, konstatohet se informacioni dhe dokumentet për studentët e stafin akademik të angazhuar në programet e studimit të aplikuar për akreditim, aksesohen sipas hierarkisë dhe funksioneve menaxheriale. Kështu, studentët kanë akses për pedagogët dhe anasjelltas në nivele akademike, ndërkohë që strukturat administrative kanë akses tek dy palët e mësipërme në lidhje me aspektet financiare dhe të tjera të natyrës administrative.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga vizita në terren, dhe nga bisedat me studentët, ekspertët konstatuan prezencën e platformave virtuale të mësimdhënies (google meet) të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit, të përmirësuara edhe për shkak të kushteve të diktuar nga pandemia. Platformat janë të personalizuar sipas funksionit.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 8 dhe nga biseda me grupin e punës së NJSBC konstatohet se njësia e garantimit të cilësisë ka përcaktuar procedura për të monitoruar në kohë reale dhe vazhdimisht aktivitetin akademik. Nga dokumentat e ngarkuara në ASCAL nuk mund të nxirret një përfundim i saktë për</p>

	frekuencën e kontrolleve dhe raportimeve, por nga bisedat me stafin akademik dhe studentët pohojnë se ky proces është optimal. Përsa i përket aspektit administrativ, institucioni ka instaluar kamera dhe sisteme sigurie për të garantuar dhe raportuar në kohë mbi sigurinë dhe kujdesin e shërbimeve të ofruara.								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga inspektimi i prezencës online të këtij institucioni në faqen e tij zyrtare https://kolegjiprofesional.edu.al/ , konstatohet se ky kriter përmbushet.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>GVJ referuar aneksit 5 të Rregullores së KPT konstatoi se çdo informacion në lidhje me pranimet bëhet publik në faqen zyrtare të kolegjit duke respektuar udhëzimet përkatëse dhe aktet nënligjore të MASR.</p> <p>Referuar dokumenteve aneksit 19 mbi syllabuset (vlerësimi i dijeve të nxëna).</p> <p>GVJ nuk konstatoi të ekzistonte një model vendimi mbi ekuivalentim dhe transferim kreditesh, apo një rregullore e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Nga konsultimi me faqen online të subjektit, https://kolegjiprofesional.edu.al/, nuk vërehet po ashtu të ketë informacion për transferimin e studimeve për të interesuarit.</p> <p>Në hartimin e RVB-së, GVB flet për procesin e transferimit dhe rruga e ndjekur për këtë proces. Duke nisur nga kërkesa me shkrim, dorëzimi i planit mësimor dhe syllabuset e lëndëve dhe më pas bëhet e ditur numri i krediteve të njohur të aplikantit.</p>

<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentat e cituara më lart, konstatohet se vlerësimi në aplikim, pranimi, mësimdhënia dhe diplomimi i studentëve në programin e aplikuar për akreditim kryhet mbi parimet e mos diskriminimit mbi çdo lloj karakteristike individuale, barazisë dhe të drejtave universale. Kriteri për pranim dhe diplomim i referohet meritës në arritjet universitare të ciklit paraardhës (pranim) dhe kryerjes së studimeve (diplomim).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentet e depozituara në ASCAL konstatohet se përmbahen materiale që dokumentojnë kërkesat e këtij kriteri. Në bazë të Ligjit 80/2015, Udhëzimeve të përvitshme të ministrit përgjegjës për arsimin, si edhe statutit institucional (nenit 59, pika 4) kriteret hartohen dhe propozohen nga njësitë bazë, miratohen nga Senati dhe i përcillen MASR-së dhe QSHA-së. Në asnjë aneks të depozituar nuk gjendet një dokument i tillë. Nga konsultimi me prezencën në rrjetet sociale të subjektit, konstatohet se publikohen kriteret për pranimin në këtë kolegji.</p> <p>Nga konsultimi me aneksin 8 (politika e marketingut përmban duket qartë se se institucioni e plotëson këtë kriter).</p> <p>Pra nga siti i KPT dhe aneksi 51 konstatohet se institucioni bën marketing të produkteve të tij lidhur me këto programe studimi, duke udhëzuar publikun. Në faqet e mësipërme sociale të subjektit, konstatohet një prezencë e mirë e udhëzimeve dhe orientimeve për të interesuarit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Nga konsultimi me syllabuset e lëndës (aneksi 19), konstatohet se në rubrikën e vlerësimit të dijeve përmbahen të plota procedurat për përparimin akademik në vitin mësimor, sikurse edhe për avancimin midis viteve akademike.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar statutit dhe rregulloreve institucionale (për aq sa janë ngarkuar në ASCAL dhe aksesohen në faqen online të subjektit) informacioni në lidhje me kërkesat e këtij kriteri plotësohet tërësisht nga institucioni. Takimet me studentët e konfirmuan një fakt të tillë.</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Nga konsultimi me prezencën online të subjektit (faqe zyrtare dhe rrjete sociale) konstatohet se institucioni në mënyrë sistematike dhe rigorozë organizon takime fizike dhe virtuale me të interesuar për studentë të ardhshëm, sikur harton broshura udhëzuese për kriteret, kushtet dhe avantazhet e regjistrimit në këtë IAL.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	Nga aneksi 58 (punësime dhe komunikimi me bizneset), aneksi 51 mbi politikat e marketingut, referuar sitit të universitetit mund të vihet re qartë që informacioni është i aksesueshëm në disa forma: forma fizik, guida, rregullore, fletpalosje. Përmes Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës, studentëve iu jepet informacion i hollësishëm. Pra ky kriter plotësohet totalisht			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	GVJ referuar anekseve 57, 32, 4 & 19 si dhe duke iu referuar takimeve me pedagogët dhe studentët, arrin në konkluzion se praktikat profesionale janë pika e fortë e KPT dhe ky kriter realizohet plotësisht.			
Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	KPT në fillim të çdo viti akademik bën publike në faqen zyrtare të internetit të gjitha kriteret e pranimit për kandidatët. Këto kriteret referuar Aneksit 2 janë të përcaktuar në statutin e KPT në nenin 21. Kriteret në fjalë janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të përcaktuara nga MASR. Po ashtu KPT përdor dhe një sërë eventesh të ndryshme për të ndryshme për të informuar maturantët (aneksi 48).			
Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga takimi me stafin dhe studentët, u konstatua se, edhe për shkak të pandemisë, informacioni është lehtësisht i disponueshëm edhe në distancë, sikurse i gjurmueshëm nga të gjitha strukturat menaxheriale të përfshira (pedagogët për mësimdhënien, NjsBC për kontrollin dhe sekretaria e administrata për regjistrimin dhe raportimin).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në

lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi			
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni dhe njësitë përgjegjëse mbajnë statistika vjetore mbi numrin e studentëve aktualë dhe të diplomuar në programin e ndryshëm të studimeve ndërsa për programin e aplikuar për akreditim nuk kishin të dhëna pasi nuk është diplomuar akoma grupi i parë i studentëve (aneksi 30). Nga vizita në sekretarinë mësimore, të dhënat për studentët që vijonin ndjekjen e programit të studimit, janë të plota dhe të mbajtura me kujdes, si nga pikëpamja sasiore, ashtu edhe ajo cilësore.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mësimore, sikurse referuar aneksit të tabelave përmbledhëse (aneksi 27), subjekti mban statistika të sakta dhe të plota në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi, tërheqjet nga programi dhe largimi para përfundimit të programit, gjithashtu edhe për studentët të cilët nuk arrijnë të përfundojnë me sukses vitin akademik.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Nga vizita në sekretarinë mësimore, inspektimi rastësor i regjistrit të studentëve, konstatohet se të dhënat për ecurinë akademike regjistrohen dhe ruhen korrektësisht. Këto të dhëna përputhen me ecurinë e përmbajtur në procesverbal.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga vizita në sekretarinë mësimore dhe inspektimi me zgjedhje rastësore i të dhënave elektronike të studentëve, konstatohet ruajtja elektronike e të dhënave, aksesimi i tyre sipas hierarkisë dhe funksionit të personit të interesuar, si edhe siguria e tyre përmes platformave mbrojtëse (antivirus, fireëall, etj).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Referuar anekseve 27, 28, 29 & 30, GVJ kostatoi hartimin e analizave periodike mbi hyrjet, daljet dhe punësimit të studentëve. Referuar aneksit 29 mbi të dhënat tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve konstatohet raportimi mbi punësimin e studentëve dhe përpjekjet për përmirësimin e treguesve të performancës për programet e tjera studimore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Ligji i arsimit të lartë e lë në tagër të vetë IAL-së (për IAL-të jopublike) modalitetin e angazhimit të studentëve në zgjedhjet dhe pjesëmarrjen e tyre në strukturat drejtuese të institucionit ku studiojnë. Nga statuti i KPT (aneksi 2) në nenin 21, pika 6, cilësohet se studentët përfaqësohen në senat me 1 anëtar. Gjithashtu, në aneksin 29 vërehet se NJSBC e përbërë nga 5 anëtarë, njërin prej tyre e ka studentë. GVJ konstatoi po ashtu se në aneksin 62 se KPT ka një këshill studentor i cili është një organizëm i pavarur i studentëve të këtij kolegjii. I zgjedhur nga vetë studentët për të përfaqësuar interesat e tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ nga rishikimi i dokumentacionit të karikuar nga KPT në portalin e ASCAL e ka të pamundur konkludimin për kërkesat e këtij kriteri.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 19, si edhe intervistat me stafin pedagogjik dhe drejtuesit e institucionit, ngarkesa e parashikuar mësimore për studentët është normale. GVJ referuar aneksit 46 mbi manualin e studentit, konstaton se KPT pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetës nga IAL e tjera vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve në IAL-të e tjera. Referuar aneksit 7 i cili përmban “Shkresën nr.Prot. 594/1, datë 29.1.2020 të KPT drejtuar MASR dhe QShA “Dërgohen kriteret e pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve për ndjekjen e programeve të studimit me karakter profesional për vitin akademik 2021-2022”. Janë të paërcaktuara edhe kriteret e pranimit. Po ashtu këto kritere rezultojnë të publikuara edhe në faqen e internetit të KPT shih https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 19, sikurse bisedat me pedagogët që lëvrojnë lëndët, krijohet bindja e arsyeshme se hartimi, implementimi dhe përmirësimi i programeve të studimit është më tepër funksion i lëndëve që zhvillohen në programet e tjera të KPT sesa produkt i bashkëpunimit me studentët, nevojat individuale të KPT dhe krijimit të një <i>niche</i>-je në tregun e arsimit të lartë e më tej të punësimit. Kjo është një praktikë e vërtëktuptueshme nisur nga numri i studentëve që studiojnë në këtë program dhe pjesën e tregut që zë institucioni në përthithjen e studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë</p>	<p>Nga aneksi 40/41 konstatohet dokumenti tip dhe një ilustrim i vjeljes së mendimeve të studentëve për kërkesat e këtij kriteri. Nga bisedat me studentët konfirmohet edhe që studenti gëzon të drejtën</p>

mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	e shprehjes së mendimit mbi barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit të provimit. Çdo student ka të drejtën e ankimimit të rezultatit të provimit, rishikimit të tezës dhe reflektimit nga ana e njësisë dhe pedagogut përgjegjës. Pra ekziston në praktikë anketimi dhe <i>feedback</i> -u.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Në bazë të Ligjit 80/2015, krijimi i strukturave studentore për IAL-të jopublike parashihet në statutin institucional. Nga konsultimi online me këtë statut, konstatohet se nenet 73, 74 dhe 77 shprehen për krijimin e këshillave studentorë, zyrën e studentit dhe këshillimit të karrierës, si edhe sekretarisë mësimore, respektivisht. Nga dokumentacioni i depozituar në ASCAL, procedurat për shërbim dhe informim të studentëve konstatohen në anekset 12 & 17 si dhe nga takimi me pedagogët dhe drejtuesit e subjektit pohohet verbalisht performanca e saj procedurale dhe rezultative. Nga inspektimi në terren, mjediset e bibliotekave dhe asistencës logjistike me akses në Internet, fotokopje, etj., janë funksionale.
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në ditët e sotme, ku informimi përmes rrjeteve sociale e bën të lehtë aksesimin e informacionit, kërkesat e këtij kriteri përmbushen lehtësisht. Kështu, KPT ka ngritur një rrjet interneti për informim, asistim dhe këshillim, si për procesin mësimor, ashtu edhe për aktivitete të tjera që organizohen nga institucioni.
Kriteri 3. Përmes zyrës/njësisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Sikurse cituar më lart, statuti i KPT parasheh ngritjen e kësaj zyre të karrierës (aneksi 17). Nga ky aneks nuk mund të konkludohet sasia dhe cilësia e me të cilën ZKK orienton studentët në lidhje me praktikën profesionale dhe tregun e punës.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon	Nga aneksi 17, referuar analizave të bëra, ZKK ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi sasinë e punësimit të tyre,

<p>e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>sikurse edhe për cilësinë (të punësuar në profesion ose jo) dhe ua lënë në dispozicion të interesuarve në nivel studentit dhe drejtuesit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Asnjë përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional
“Administrim Zyre” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”**

Pikat e forta dhe afirmime

1. KPT disponon një infrastrukturë të mirë materiale për të realizuar suksesshëm mësimdhënien në programin e aplikuar për akreditim.
2. KPT ka një staf pedagogësh që e njohin mirë praktikën dhe janë profesionistë me eksperiencë.
3. KPT ka një sërë marrveshjesh bashkëpunimi me institucione publike dhe organizata private të cilat ndihmojnë në rritjen e profesionalizmin të studentëve përmes zhvillimit të praktikave mësimore.

Pika të dobta

1. KPT nuk ka bërë një studim të mirfilltë tregu për të kuptuar saktë nevojën që ka tregu për programin e studimit me karakter profesional “Administrim Zyre”.
2. Kurrikula e programit të studimit me karakter profesional “Administrim Zyre” është shumë teknike dhe një pjesë të moduleve mendojmë se nuk i ka adapte për programin studimor në fjalë.
3. KPT përdor literaturë të vjetëruar në përgatitjen e studentëve për programin e aplikuar për akreditim.
4. Një pjesë nga profesorët me tituj dhe grada, përfshirë drejtuesit e departamentit të programit të studimit janë në një moshë përtej afateve të përcaktuara në ligj.
5. Stafi ri akademik nuk disponon tituj akademik.

Rekomandime

1. GVJ rekomandon të bëhen studime tregu parësore për programin e aplikuar për akreditim për të kuptuar konkurrencën, identifikuar avantazhet e disavantazhet dhe rritur shanset për sukses.
2. GVJ rekomandon KPT të shohë dhe analizojë kurrikula të ngjashme të ofruar nga Kolegjet e tjerë profesionalë për programin e studimit me karakter profesional “Administrim Zyre” si dhe duhet të përmirësojë kurrikulën mësimore duke e vendosur në funksion të studentit dhe jo në funksion të kompetencave të stafit akademik.
3. GVJ rekomandon KPT, për programin e studimit me karakter profesional “Administrim Zyre” të përdor literaturë të koheve të fundit për përgatitjen e studentëve për tregun e punës.
4. GVJ rekomandon KPT të stimulojë kërkimin shkencor dhe marrjen e gradave dhe titujve akademik për stafin e tij si dhe të zëvendësojë profesorët me tituj në pension.

Evaluation Conclusions of the professional character study program "Office Administration" of the Higher Education Institution "Professional College of Tirana"

Strengths and affirmations


1. The PCT has a good material infrastructure to successfully carry out teaching processes in the program under accreditation.
2. The PCT has a teaching staff who are well acquainted with the practice and are experienced professionals.
3. The PCT has a number of cooperation agreements with public institutions and private organizations which help increase the professionalism of students through the development of teaching practices.

Weaknesses

1. The PCT has not conducted a proper market study to accurately understand the market need for a professional study program such as "Office Administration".
2. The study program's curriculum is very technical and some of the modules we think are not adapted for the study program in question.
3. The PCT uses outdated literature in preparing students for the study program under evaluation.
4. Some of the professors with titles and degrees, including the heads of the department of the study program are at an age beyond the deadlines set by law.
5. New academic staff do not have academic titles.

Recommendation

1. EEG recommends conducting primary market studies for the program under evaluation to understand the competition, identify the advantages and disadvantages and increase the chances of success.
2. EEG recommends PCT to see and analyze similar curricula offered by other professional Colleges for the study program with professional character "Office Administration" and should improve the curriculum by placing it in the function of the student and not in the function of competencies of the academic staff.
3. EEG recommends PCT, for this study program to use recent literature to prepare students for the labor market.
4. GVJ recommends PCT to stimulate scientific research and obtaining degrees and academic titles for its staff as well as to replace retired professors with titles.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

